



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 194 Prot.

Tiranë, më 17.032015

VENDIM Nr. 22, datë 11.03.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 3, të datës 11.03.2015, pasi shqyrtoi "Relacionin për vlerësimin në terren të potencialit arkeologjik të varreve të hapura nga gërmimet klandestine, në nekropolin e qytetit antik të Orikut-Vlorë", paraqitur nga ASHA, IA, DRKK-Vlorë,

VENDOSI:

- I. Instituti i Arkeologjisë-Misioni Shqiptaro Zvicerian, i cili po kryen punime në këtë zonë, në kuadër të projektit kërkimor-shkencor "Orikumi", miratuar me vendim KKA nr. 310, datë 04.06.2014, të paraqesë një propozim për zgjerimin e zonës së mbrojtur arkeologjike Orikum-Vlorë.
- II. Për të gjitha varret e hapura në mënyrë klandestine, arkeologët e ASHA të kryejnë dokumentimin e tyre, në bashkëpunim me DRKK-Vlorë. Pas përfundimit të dokumentimit, DRKK-Vlorë të realizojë mbylljen dhe mbulimin e varreve të hapura, me qëllim mosdëmtimin e mëtejshëm të tyre.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: www.asha.gov.al